

Si të ankoheni

Pra, si të ankohem tek PPO (Avokati i Popullit i Burgjeve dhe Shërbimit të Provës)?

Ndiqui këto **tre hapa të thjeshtë**:

1. Sigurohuni që, së pari, të kaloni të gjithë procesin e ankesave të qendrës së emigracionit të largimeve.
2. Shkruani një shënim të shkurtër duke na treguar se për çfarë bën fjalë ankesa juaj dhe pse nuk jeni ende të kënaqur.
3. Na dërgoni kopje të të gjitha dokumenteve tuaja – duke përfshirë të gjithë formularët e ankesave në qendrën e emigracionit.

Ne e kemi përkthyer këtë në shumë gjuhë. Nëse nuk mund të gjeni një fletëpalosje në gjuhën tuaj, ju lutemi na kontaktoni.

Ku të dërgoni ankesën tuaj

Ku t'i dërgoj të gjitha dokumentet e mia?

Dërgoni kopjet e të gjitha dokumenteve të ankesave tuaja në këtë adresë:

Prisons and Probation Ombudsman Third Floor, 10 South Colonnade Canary Wharf, London E14 4PU

Letrat tuaja, drejtuar Avokatit të Popullit të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës, janë **pa pagesë**. Posta e letrave tuaja do të paguhet nga IRC (Qendra e Emigracionit për Largimet)

Kini parasysh, **mos na dërgoni dokumente origjinale pasi nuk mund t'i kthejmë ato.**

Prisons &
Probation
Ombudsman
Independent Investigations

Si të ankoheni tek Avokati i Popullit i Burgjeve dhe Shërbimit të Provës (PPO)

Keni bërë një ankesë dhe nuk jeni akoma të kënaqur?

Ndoshta ju duhet të flisni me Avokatin e Popullit të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës.

A e dini?

- Çdo vit, PPO merr mijëra **ankesa, duke përfshirë ato nga individë të ndaluar.**
- Në përgjigje të këtyre ankesave, ne u bëjmë **rekomandime qendrave të emigracionit të largimeve** dhe rezultatet e hetimeve tona synojnë t'i bëjnë ato një **vend më të mirë, më të sigurt** për të ndaluarit në të gjithë vendin.

**Keni humbur një send personal?
Mendoni se jeni trajtuar në
mënyrë të padrejtë? Kontaktoni
PPO-në.**

E vërteta për PPO-në

- Ne nuk punojmë për Ministrinë e Brendshme apo për Zbatimin e Vendimeve të Emigracionit. PPO është **plotësisht i pavarur.**
- Letrat tuaja për ne **nuk do të lexohen nga IRC-ja** dhe nuk do të përdoren kundër jush. Ju nuk do të keni asnjë problem për të na dërguar një ankesë.
- Ne marrim ankesa nga të ndaluarit çdo vit. **Ne mund t'ju ndihmojmë, gjithashtu.**
- **Nëse jemi dakord me ju, mund të merrni një falje; t'ju mbulohet humbja ; apo të ketë edhe një ndryshim në mënyrën e funksionimit të qendrës.**
- Ne do t'ju njoftojmë nëse mund ta hetojmë ankesën tuaj **brenda 10 ditëve** nga marrja e saj.

Për çfarë mund të ankoheni?

**Në rregull, për çfarë
mund të ankohem?**

Ju mund të ankoheni në PPO për të gjitha llojet e çështjeve – që nga mënyra se si ju trajton stafi, sendet e humbura personale, apo edhe për transportin ndërmjet burgjeve, qendrave të paraburgimit ose vendit tuaj.

Ne nuk mund të hetojmë:

- Ankesat apo vendimet për rastet e emigracionit.
- Ankesat për kujdesin mjekësor.
- Si rregull i përgjithshëm, nëse kanë kaluar më shumë se 3 muaj nga përgjigja përfundimtare nga qendra e emigracionit të largimeve për ankesën tuaj origjinale.
- Ankesa duhet të jetë për diçka që ju ka ndodhur juve, jo dikujt tjetër.
- Nëse jeni duke marrë, ose keni hapur një çështje ligjore për të njëjtën çështje.